

Projekt-kushtetutë për Besëlidhjen Shqiptare

— 28 nëntor 2019 —

Hartoi:

Getoar Mjeku, JD

avokat ndërkombëtar

gm@getoar.com

Botoi:

Plisi.org • Prishtinë, Kosovë

— botu së pari: 10.6.2019

— përditësu së mbrami: 28.11.2019

— vegëza: plisi.org/pk-beselidhja

Fonti:

Liberation Serif, 11 pt



Ky material botohet sipas licencës CC BY-ND 4.0

Lejohet me e kopju dhe shpërnda në çfarëdo forme, qoftë dhe për fitim. Por duhet me cekë autorin dhe me përfshi këtë njoftim. Ndalohet me ndryshu përmbajtjen pa lejen e autorit.

Licencën e ka përpilu organizata amerikane «Creative Commons» për t’u ndihmu autorëve dhe publikut me shpërnda dhe me ripërdorë punët krijuese sipas ligjit.

Lexoji kushtet e licencës këtu:

<https://creativecommons.org/licenses/by-nd/4.0/>.

Përmbajtja

Parafjalë.....	5
Përzgjedhja e fjalëve.....	7
Hyrje.....	8
Kreu I Parime të përgjithshme.....	9
Neni 1. Shqipëria.....	9
Neni 2. Ligji.....	10
Neni 3. Parime të qeverisjes.....	10
Neni 4. Besëlidhja dhe shtetet.....	11
Neni 5. Vetëqeverisja vendore.....	12
Neni 6. Vetvetësia e Besëlidhjes.....	13
Kreu II Të drejtat themelore.....	13
Neni 7. Përcaktimi.....	13
Neni 8. Jeta dhe denjësia.....	14
Neni 9. Barazia.....	15
Neni 10. Privatësia.....	16
Neni 11. Liria vetjake.....	16
Neni 12. Drejtësia.....	17
Neni 13. Shtetësia.....	19
Neni 14. Lëvizja.....	20
Neni 15. Liria shpirtërore.....	20
Neni 16. Liritë qytetare.....	20
Neni 17. Demokracia.....	21
Neni 18. Familja.....	22
Neni 19. Prona.....	22
Neni 20. Puna dhe mirëqenia.....	23
Neni 21. Zhvillimi.....	23
Neni 22. Mjedisi dhe pasuritë.....	24
Neni 23. Shpenzimet botore.....	25
Neni 24. Komunitetet.....	25
Neni 25. Kufizimet.....	25
Kreu III Prijetari.....	26
Neni 26. Përcaktimi.....	26

Neni 27. Zgjedhja.....	27
Neni 28. Mandati.....	28
Neni 29. Shkarkimi.....	28
Kreu IV Kuvendi.....	29
Neni 30. Përcaktimi.....	29
Neni 31. Zgjedhja.....	30
Neni 32. Mandati.....	30
Neni 33. Kryesia.....	31
Neni 34. Puna.....	31
Neni 35. Rregulloret.....	32
Neni 36. Ligjvënia.....	33
Neni 37. Marrëveshjet ndërkombëtare.....	33
Kreu V Qeveria.....	34
Neni 38. Përcaktimi.....	34
Neni 39. Emërimi.....	35
Neni 40. Mandati.....	37
Kreu VI Gjyqësia.....	38
Neni 41. Përcaktimi.....	38
Neni 42. Gjykata e Naltë.....	38
Neni 43. Dhoma Kushtetutore.....	39
Neni 44. Këshilli Gjyqësor.....	40
Neni 45. Emërimi.....	40
Neni 46. Mandati.....	41
Neni 47. Shkarkimi.....	41
Kreu VII Organet e posaçme.....	42
Neni 48. Në përgjithësi.....	42
Kreu VIII Mbrojtja dhe rendi.....	43
Neni 49. Organet.....	43
Neni 50. Masat e jashtëzakonshme.....	44
Kreu IX Të ndryshme.....	45
Neni 51. Zgjedhjet.....	45
Neni 52. Betimi.....	46
Neni 53. Shlirimet.....	46
Neni 54. Ndryshimi i Kushtetutës.....	47
Neni 55. Kalimtare.....	47

Parafjalë

Kjo është përpjekje me hartu një kushtetutë moderne shkurt e shqip¹ — në gjuhë të thjeshtë e të thukët — për një federatë të shteteve shqiptare.

Projektin e kam nisë me bindjen se shqiptarët janë një komb i pandashëm. Të parët tanë kanë farkëtu vetvetësinë kombëtare në truallin e njëshëm, përmes gjuhës së përbashkët; falë një trangu dokesh, ligjesh, përjetimesh e synimesh; dhe në sajë të lidhjeve tona të gjakut a të afrisë së krijuar ndër shekuj. Andaj, shqiptarët në trojet e veta natyrshëm kërkojnë bashkimin kombëtar — që nënkupton me jetu brenda një trupi politik.

Bashkimi i mirëfilltë krijon hapësirën ku kombi ynë të frymojë i lirë dhe të përparojë sipas rrethanave, përvojave, e interesave të veçanta e të përbashkëta. Prandaj ky projekt mbështet ngritjen e një shteti federativ — Besëlidhjen Shqiptare — me Shqipërinë Londinare dhe Kosovën ndër shtete anëtare. Ndonëse copëtimi i trojeve tona ka qenë vepër e huaj dhe padrejtësi e madhe ndaj popullit tonë, shtetet tona i kemi ndërtu vetë dhe me ndihmën e miqve, andaj lypset t’i çmojmë dhe t’i forcojmë më tej.

Projekti i shërben këtij ideali të kahmotshtëm në rrethanat e shekullit të ri. Qysh në hyrje, përqafon vlerat e gjithësishe, lartëson mosdiskriminimin dhe diversitetin, dhe cek aspiratën e shqiptarëve për t’u anëtarësu në Bashkimin Evropian. Kreu I përkufizon Shqipërinë si shtet që respekton të drejtën ndërkombëtare, kurse kreu II mbron të drejtat themelore prerazi, duke parapa mes të tjerash forcimin e demokracisë, barazinë gjinore, të drejtat shoqërore, të drejtat e komuniteteve, si dhe sfidat në botën digjitale. Projekti përcakton shkoqur ko-

1 Shih kuptimin e fjalës *shqip* në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, AShSh (2006), fjalorthi.com/shqip; shih dhe shkrimin tim, «Shkruaj shkurt e shqip», *Plisi.org* (27.4.2018), plisi.org/?p=4942.

mpetencat e qeverive federative e shtetërore, parasheh zgjedhje me orar fiks, vendos rregulla të qarta për zgjedhjen dhe emërimin e zyrtarëve kyçë, dhe forcon mëvetësinë e gjyqësorin dhe organeve të posaçme. Mbi të gjitha, zvogëlon mundësinë me keqpërdorë pushtetin.

Teksti mbështetet kryesisht në një projekt-kushtetutë që fillimisht e kam hartu për Kosovën.² Me rreth 7 mijë fjalë, do të hynte ndër 20 kushtetutat më të shkurta; me përmbajtje ndër më demokratiket.³ Për krahasim, Shqipëria e Kosova kanë kushtetuta mbi dy herë më të gjata.

Stili i hartimit parapëlqen thjeshtësinë e qartësinë, duke huazu nga përvojat e vendeve të zhvilluara që po i përmirësojnë ligjet e veta duke i rishkru në gjuhë që e kuptojnë qytetarët e rëndomtë.⁴ Teksti synon me thënë më shumë me më pak. Shmang përsëritjet dhe sinonimet, parapëlqen njëtrajtësinë, dhe rendit përmbajtjen logjikshëm. Aty-këtu përdor ndonjë fjalë më të vjetër nga tradita letrare dhe juridike shqiptare, veçmas në hyrje, por pa cenu kuptimin.

Këtë dorëshkrim po ua dorëzoj për lexim e diskutim dashamirëve të ligjit dhe të bashkimit kombëtar këtë 28 Nëntor 2019, në 22-vjetorin e shfaqjes së Ushtrisë së Çlirimtare të Kosovës dhe në 20-vjetorin e çlirimit.

Getoar Mjeku
nëntor 2019

2 Projekt-kushtetutë për Kosovën (2019), *Plisi.org*, plisi.org/pk19/.

3 Comparative Constitutions Project, «Constitution Rankings», përdit. 8.4.2016, comparativeconstitutionsproject.org/ccp-rankings.

4 Shih Mjeku, «Shkruaj shkurt e shqip», citu sipër, plisi.org/?p=4942.

Përzgjedhja e fjalëve

Projekti synon me përdorë fjalët më të thjeshta e më të përhapura që mundet, përveç rasteve ku qëllimisht i zëvendëson me sinonime nga tradita ose rrënjët vendase.⁵

Këto fjalë ose togje fjalësh përdoren në tërë projektin:

- Emri **besëlidhje** domethënë federatë.⁶
- Emri **shtet** domethënë Besëlidhja ose njëri nga shtetet e Besëlidhjes.⁷ Në çdo rast nënkupton shtetin që ka tagër mbi lëndën. Shumësi *shtetet* domethënë shtetet e Besëlidhjes, përveç nëse qartazi ka kuptim tjetër. Në rasën gjinore të trajtës së pashquar *i/e një shteti* domethënë i/e një prej shteteve të Besëlidhjes, përveç nëse qartazi ka kuptim tjetër.
- Togu **shtet i huaj** domethënë shtet sovran jashtë Besëlidhjes.
- Mbiemri **shtetëror** (*shtetërore*) domethënë i shtetit, që i bie Besëlidhjes ose i një shteti të Besëlidhjes.
- Mbiemri **botor** (*botore*) domethënë publik.⁸

Fjalët e veçanta të këtij projekti shpjegohen në poshtëshënime, ku jepen si alternativë sinonimet më të përhapura.

5 Zëvendësimi i huazimeve të mirëpërhapura me rrënjë vendase më pak të njohura është kryesisht ndjenjësor, dhe nuk i shërben ndonjë qëllimi praktik. Madje, shpesh bie ndesh me parimin e gjuhës së thjeshtë. Shih shënimin 1, sipër.

6 Kjo skajëz është përdorë në nderim të besëlidhjeve historike të shqiptarëve, siç kanë qenë Besëlidhja e Arbrit, e themeluar më 1444, dhe Lidhja e Prizrenit e 1878-s.

7 Për ta theksu dallimin mes Besëlidhjes dhe shteteve të saj mund të përdorim si sinonim emrin *qeveri* — pra, me kuptimin e institucioneve shtetërore, përfshi ligjvënësin, ekzekutivin, dhe gjyqësorin, siç ndodh rëndom në traditën amerikane (*government*).

8 Shih Fjalorin, ASHSh (2006), fjalorthi.com/botor.

Hyrje

Ne, populli zot e krenar⁹ i Shqipërisë së lirë, lidhë besa-besë —
me i mbrojtë vlerat e gjithësishtme të njerëzimit dhe të drejtat e pa-
tjetërsueshme të secilit njeri pa dallim,¹⁰ me rujtë vetvetësinë e lar-
minë tonë në dheun stërgjyshor,¹¹ dhe me jetësu vegimin e të parëve
tanë¹² dhe ëndrrat e brezave që vijnë,
duke ndërtuar një shtet-besëlidhje të drejtë, përparimtare, e të fuqish-
me, që do të rrojë me nder në gjirin paqedashës të kombeve euro-
atlantike, tash e sa të ketë mot —
shpallim dhe vendojmë këtë Kushtetutë.

9 Fjala *zot* thekson sovranitetin e popullit. Shkruhet me të vogël, meqë dallon nga emri *Zot* si sinonim për Perëndi apo Hyj. Dyzimi *zot e krenar* shfaqet letërsi e shumë fjalime atdhetare, përfshi një nga vargjet e Mitrush Kutelit, në veprën *Poem kosovar* (1943).

10 Një draft i mëhershëm i preambulës së këtij projekti theksonte besën ndaj denjësisë, barazisë e lirisë.

Këto qenë reformulim i parimeve themelore që At Zef Valentini ka nxjerrë nga e drejta dokesore kosovare: nderi i vetës, barazia e të gjitha vetave, liria individuale brenda kufijve të ligjit, dhe besa. Shih Noel Malcom, *Kosovo: A Short History* (HarperPerennial, 1999), f. 18 (citon G. Valentini, red., *La legge delle montagne albanesi nelle relazioni della missione volante 1880–1932* (Florence, 1969), f. x–xi). Këto parime ngjasojnë me trininë e John Lockeut, që amerikanët e poetizuan si «jeta, liria dhe ndjekja e lumtunisë». Shih John Locke, *Second Treatise of Government* (London, 1690), para. 87, www.gutenberg.org/etext/7370; dhe përkthimin shqip të Deklaratës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara, plisi.org/plisi.org/?p=439.

Versioni i tashëm përmend theksojnë vlerat e gjithësishtme dhe të drejtat e njeriut, meqë këto ngërthejnë medoemos konceptet që përmendin Valentini e Locke.

11 Fjala *vetvetësi* (ose vetëvetësi) ka kuptimin e identitetit. Ideja e frazës është me e rujtë identitetin kombëtar në trojet shqiptare, që shqiptarët si popull vendas i kanë trashëgu nga paraardhësit.

12 *Vegimi* (apo vizioni) i të parëve nënkupton në radhë të parë idealet e rilindasve, të cilët nderonin kujtimin e luftës heroike të Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe bënin thirrje për një Shqipëri të lirë e përparimtare. Njëherësh ngërthen dhe përpjekjet e të gjithë brezave për liri dhe demokraci në trojet tona.

Kreu I

Parime të përgjithshme

Neni 1. Shqipëria

1. **Përcaktimi.** Shqipëria është shtet i pavarur e sovran i themeluar si:
 - (1) besëlidhje e shteteve shqiptare;¹³
 - (2) republikë parlamentare;
 - (3) demokraci shoqërore e liberale; dhe
 - (4) shoqëri e hapur dhe shekullare.
2. **Përbërja.** Besëlidhjen e përbëjnë:
 - (1) Shteti i Arbrit;¹⁴
 - (2) Shteti i Dardanisë;¹⁵ dhe
 - (3) shtetet që mund t’i bashkohen.
3. **Trualli.** Trualli shqiptar është një dhe i pacenueshëm.
4. **Sovraniteti.** Sovraniteti¹⁶ i përket popullit, i cili sundon përmes përfaqësuesve të zgjedhur.

13 Alternativë: «shteteve dhe trevave shqiptare». Trevat mund të krahasohen me territoret ose distriktet federative në ShBA, Kanada, Australi dhe federata të tjera. Ato përmendet qartë këtu për t’u siguru se nuk mbeten pa të drejtën e vetëqeverisjes ose pa përfaqësim në qeverinë e Besëlidhjes.

Nëse trevat e këtilla parashihen me kushtetutë, atëherë *qeverisja e trevave* do të duhej të cekej ndër kompetencat përjashtuese të Besëlidhjes (Neni 4.1). Një paragraf i veçantë në po atë nen do të përcaktonte: Trevat kanë të drejtën e vetëqeverisjes vendore dhe tagrin që ua jep Besëlidhja. Gjithashtu, për trevat do të ruhej një numër i caktuar i logtarëve dhe pleqnarëve (Neni 31).

Një tjetër mundësi është që në rregullat për vetëqeverisjen vendore (Neni 5) me parapa edhe trevën si njësi e një shteti që vihen nën tagrin e Besëlidhjes dhe që gëzon të drejtën e vetëqeverisjes vendore sipas një ligji federativ.

14 Republika e Shqipërisë, me kufijtë e caktuar më 1913, ndryshu pjesërisht më 1921, dhe konfirmu më 1926 dhe 1945. Më parë, është propozu që shteti të quhet *Republika e Shqipërisë Perëndimore*, ashtu që emri Shqipëri të mos përjashtojë trojet e tjera kombëtare.

15 Republika e Kosovës me kufijtë që ka pasë kur ka shpallë pavarësinë më 2008.

16 Alternativë — Ky paragraf mund të zëvendësohet me një nen titullu «Sovraniteti» si vijon:

Neni 2. Ligji

1. **Në përgjithësi.** Të gjithë i nënshtrohen ligjit.
2. **Hierarkia.** Janë ligj i vendit dhe zbatohen me rend pasi të botohen:
 - (1) e drejta e detyrueshme ndërkombëtare;
 - (2) Kushtetuta e Besëlidhjes;
 - (3) marrëveshjet ndërkombëtare që i ratifikon Shqipëria;
 - (4) normat e një organizate ndërkombëtare që Shqipëria është pajtuar t'i zbatojë drejtpërdrejt;
 - (5) ligjet e Besëlidhjes dhe aktet e mbështetura në ato ligje;
 - (6) kushtetutat e ligjet e tjera të shteteve; dhe
 - (7) burimet e tjera të së drejtës.
3. **Fletorja Zyrtare.** Botohen në Fletoren Zyrtare ligjet dhe aktet e botueshme që nxjerrin organet shtetërore.¹⁷

Neni 3. Parime të qeverisjes

1. **Në përgjithësi.** Qeverisja mbështetet në:
 - (1) shtetin e së drejtës;
 - (2) zgjedhjet e lira e të periudhshme;

— Populli ka themeluar Besëlidhjen dhe shtetet për t'i mbrojtë të drejtat themelore dhe për t'i shërby të mirës së secilit dhe të gjithëve.

— Sovraniteti i përket popullit, i cili sundon përmes përfaqësuesve të zgjedhur në qeveri ose drejtpërdrejt me referendum.

— Populli lidh besën se do t'i mbrojë përjetësisht dhe me të gjitha mjetet Shqipërinë, sovranitetin e popullit, dhe të drejtat themelore. Për aq kohë sa e mban besën e dhënë, populli mund t'i bëjë Kushtetutës çfarëdo ndryshimi që e sheh të vyeshtëm.

Paragrafi i fundit është përshtatë nga Kushtetuta e Teksasit (1876/2017), ShBA, neni 1.2. Ideja është me theksu pamundësinë e ndryshimit të kushtetutës në mënyrë që pakëson të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

- ¹⁷ *Shtet* domethënë Besëlidhja ose njëri nga shtetet e Besëlidhjes. *Organ shtetëror* domethënë organ i Besëlidhjes ose i një shteti të Besëlidhjes. Për ta theksu dallimin mes Besëlidhjes dhe shteteve të saj mund të përdorim si sinonim emrin qeveri — pra, me kuptimin e institucioneve shtetërore, përfshi ligjvënësin, ekzekutivin, dhe gjyqësorin, siç ndodh rëndom në traditën amerikane (*government*).

- (3) ndarjen dhe baraspeshimin e pushteteve mes Besëlidhjes, shteteve, dhe qeverive vendore;
 - (4) ndarjen dhe baraspeshimin e pushteteve mes organeve ligjvënëse, përmbartuese, gjyqësore, dhe të posaçme;
 - (5) veprimin në shkallën më të ulët të qeverisjes që mund të veprojë efektshëm;¹⁸ dhe
 - (6) veprimin në përpjesëtim me qëllimin e veprimit.¹⁹
2. **Delegimi.** Organi që delegon përgjegjësi siguron mjetet me i përmbushë përgjegjësitë e deleguara.
 3. **Ekonomia.** Rendi ekonomik mbështetet në sipërmarrësinë e vyeshme dhe tregun e lirë. Shteti mundëson kontrollin demokratik mbi mjetet e prodhimit dhe rregullon tregun sa është e domosdoshme për mirëqenien e përgjithshme.

Neni 4. Besëlidhja dhe shtetet

1. **Besëlidhja.** Besëlidhja ka tagër përjashtues mbi:
 - (1) marrëdhëniet ndërkombëtare;
 - (2) kufijtë e Besëlidhjes dhe mbrojtjen kombëtare;
 - (3) doganat dhe tregtinë e jashtme;
 - (4) tregun ndërshtetëror;
 - (5) komunikacionin e jashtëm dhe ndërshtetëror; dhe
 - (6) prerjen e monedhës.
2. **Bashkërisht.** Besëlidhja dhe shtetet kanë tagër mbi:
 - (1) sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore;
 - (2) marrëdhëniet mes shteteve të Besëlidhjes;

18 Parimi i ndajshimitit ose subsidiaritetit, siç e zbatojnë Bashkimi Evropian dhe disa federata evropiane si Gjermania e Zvicra. Shih Traktati i Konsoliduar i BE-së (2009), neni 5; Ligji Themelor i Gjermanisë (1949/2014), neni 23.1; Kushtetuta e Zvicrës (1999/2014), neni 5A. Zbatohet edhe në qeverisjen vendore. Ligji për vetëqeverisjen vendore (Shqipëri), nr. 139/2015, nenet 2.12 dhe 10; Ligji për vetëqeverisjen lokale (Kosovë), 03/L-040, GZRK 28/2008, nenet 3 dhe 15.

19 Parimin e përpjesëtueshmërisë gjithashtu e zbaton Bashkimi Evropian. TBE (2009), neni 5.4.

- (3) mirëqenien e përgjithshme;
 - (4) mjedisin dhe pasuritë natyrore;
 - (5) sigurinë botore;
 - (6) përgjegjësitë që u delegohen; dhe
 - (7) çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.
3. **Shtetet.** Shtetet kanë tagër:
- (1) të lidhin marrëveshje ndërkombëtare me pëlqimin e Besëlidhjes brenda fushëveprimit të tyre;
 - (2) të këshillohen dhe të japin pëlqimin për marrëveshjet ndërkombëtare që prekin rrethanat e tyre të posaçme; dhe
 - (3) të këshillohen dhe të japin pëlqimin kur u caktohen kufijtë.²⁰
4. **Tagri tjetër.** Shtetet dhe populli kanë tagrin që nuk i është dhënë Besëlidhjes.
5. **Shtetet e reja.** Shtetet e reja i pranon ose themelon Kuvendi me dy të tretat e anëtarëve të secilës dhomë. Nuk mund të ketë:
- (1) njësi sovraane pos shtetit; ose
 - (2) ndarje në vija komunitare, politike, a ideologjike ose brenda hapësirave të shkëputura a të shkapërderdhura.²¹

Neni 5. Vetëqeverisja vendore

1. **Në përgjithësi.** Vetëqeverisja vendore mbrohet me ligj shtetëror. Zbatohet drejtpërdrejt Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore.
2. **Bashkitë.** Bashkia është njësi e ndarjes tokësore të shtetit dhe e qeverisjes vendore. Ka tagër:

20 Sipas kushtetutës gjermane, Ligji Themelor i Gjermanisë (1949/2014), nenet 29 e 32.

21 Qëllimi është me iu shmangë njësive të krijuara me *gerrymandering* ose për të rehatu kërkesat e komuniteteve me synime separatiste. Veçmas, nuk lejohet me lidhë hapësira gjeografike përmes korridoreve. Sipas këtij paragrafi, Shqipëria nuk do të lejonte bosnjëzimin përmes entiteteve me kompetenca sovraane a ekektive.

- (1) të nxjerrë urdhëresa e të marrë vendime brenda fushëveprimit të vet;
 - (2) të bashkëpunojnë me bashki të tjera dhe me palë të treta brenda e jashtë vendit; dhe
 - (3) të mbledhë e shpenzojnë pare dhe të marrë mjete nga organet qendrore.
3. **Viset.** Visi është njësi e ndarjes tokësore të shtetit për qëllime të organeve qendrore. Visin e përbëjnë disa bashki.²²
 4. **Mbikëqyrja.** Organet qendrore rishikojnë aktet e organeve vendore vetëm për t'u siguruar se janë në pajtim me ligjin.

Neni 6. Vetvetësia e Besëlidhjes²³

1. **Gjuha.** Gjuhë zyrtare është shqipja. Shteti mund t'i përdorë gjuhët e komuniteteve për nevojat e qytetarëve.
2. **Kryeqyteti.** Kryeqytet i Shqipërisë është Prizreni. Besëlidhja mund ta bartë selinë e një organi në qytet tjetër.
3. **Simbolet.** Flamuri i Besëlidhjes është flamuri kombëtar me shqiponjën e zezë dykrenore në një prapavijë të kuqe. Me ligj përcaktohet përmbajtja dhe përdorimi i flamurit dhe simboleve të tjera kombëtare.

Kreu II Të drejtat themelore

Neni 7. Përcaktimi

1. **Në përgjithësi.** Të gjithë njerëzve u takojnë të drejtat themelore, që janë të gjithësishme dhe të patjetërsueshme.

²² Viset janë të rëndësishme për zgjedhjet e Kuvendit të Besëlidhjes.

²³ Alternativë: *identiteti i Besëlidhjes*. Shih shënimin 11, sipër.

2. **Veta juridike.** Vetës juridike²⁴ i takojnë të drejtat themelore që janë të domosdoshme për qëllimet e saj të ligjshme.
3. **Instrumente.** Zbatohen drejtpërdrejt këto instrumente ndërkombëtare:²⁵
 - (1) Deklarata universale për të drejtat e njeriut;
 - (2) Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollat e saj;
 - (3) Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile e politike dhe protokollat e saj;
 - (4) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor;
 - (5) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas;
 - (6) Konventa për të drejtat e fëmijës;
 - (7) Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore, dhe poshtëruese;
 - (8) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
 - (9) Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare; dhe
 - (10) Karta evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave.

Neni 8. Jeta dhe denjësia

1. **Në përgjithësi.** Jeta dhe denjësia e njeriut janë të pacenueshme.
2. **Të ndaluara.** Askush nuk mund:

24 Emri *vetë* domethënë person. Pra, vetat juridike janë personat juridikë. Nga emri *vetë* rrjedh mbiemri *vetjak* (personal). Kushtetuta e Shqipërisë (1998/2016) nuk përmban emrin *vetë*, por përdor mbiemrat *vetjak* dhe *personal* me të njëjtin kuptim. Krahaso, për shembull, kreun II të pjesës së dytë dhe nenet 37.3 e 45.4 (*vetjak*) me 73.2, 126 e 137 (*personal*). Ky projekt përdor njëtrajshëm emrin *vetë* dhe mbiemrin *vetjak*.

25 Kjo listë është bartë nga Kushtetuta e Kosovës (2008/2016), nenet 22 dhe 58.2, dhe nga ndryshimi i propozuar i asaj kushtetute. Shih rastin KO 162/18, GjKK, Aktgjyk. 7.2.2019.

- (1) të dënohet me vdekje;
 - (2) të mbahet në skllavëri ose robëri;
 - (3) të shtrëngohet me bë punë të detyruara, pos shërbimit të përcaktuar me ligj për masat e jashtëzakonshme;²⁶ ose
 - (4) të trafikohet, torturohet, çnjerëzohet, ose gjymtohet.²⁷
3. **Trupi e mendja.** Çdonjërit i takon tërësia trupore e mendore. Çdonjëri ka të drejtë:
- (1) me marrë vendime lidhur me shtimin sipas ligjit;
 - (2) me pasë kontroll mbi trupin e vet;
 - (3) mos me u mjeku kundër vullnetit të vet; dhe
 - (4) mos me marrë pjesë në prova mjekësore ose shkencore pa pëlqimin e vet paraprak.

Neni 9. Barazia

1. **Përcaktimi.** Të gjithë janë të barabartë para ligjit.
2. **Mosdiskriminimi.** Ndalohet trajtimi i pabarabartë shkakut i racës, prejardhjes, kombësisë, fesë, seksit, gjinisë, mendimit politik, shoqërimit, gjendjes shoqërore, ose ndonjë gjendjeje a vetie tjetër.²⁸
3. **Përkrashja.** Shteti mbron dhe ndihmon ata që janë në gjendje të pabarabartë.

26 Çështja e shërbimit gjatë masave të jashtëzakonshme dhe e drejta e kundër-shtimit të ndërgjegjes ndaj shërbimit me armë në luftë mund të rregullohet me paragraf të veçantë. Ky paragraf do të mund të përcaktonte dhe detyrës e secilit shtetas me shërby në Ushtri ose me mbrojtë vendin: «Qytetarët kanë detyrë të mbrojnë vendin dhe të shërbejnë në Ushtri. Qytetari që për arsye ndërgjegjeje nuk pranon me shërby me armë në Ushtri ka detyrë të kryejë shërbim tjetër sipas ligjit».

27 Kjo dispozitë përfshin ndalimin e trafikimit të organeve. Shih Kartën e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian (2000/C 364/1), neni 3.2.

28 Ky paragraf ndalon diskriminimin edhe për shkaqe të orientimit seksual, vetive seksuale, ose identitetit gjinor. Këto rrethana nënkuptohen brenda seksit, gjinisë, dhe shoqërimit.

Neni 10. Privatësia

1. **Në përgjithësi.** Banesa, objektet private, dhe kumtimi vetjak janë të pacenueshëm. Mund të kontrollohen vetëm sa lejon miratimi gjyqësor.
2. **Të dhënat.** Të dhënat vetjake mbrohen me ligj. Mund të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhë.²⁹ Nuk mund të ruhen rregullisht dhe vetvetiu, përveçse sa lejon miratimi gjyqësor ose sa është e domosdoshme:
 - (1) për të regjistruar qytetarët dhe popullsinë për qëllimet e përligjshme të shtetit;
 - (2) për të përcaktuar detyrimet financiare ndaj shtetit;
 - (3) për të zbatuar ligjin ndaj veprimtarive ekonomike; ose
 - (4) për të zbatuar marrëveshjet që ka lidhë njeriu të dhënat e të cilit ruhen.³⁰
3. **Miratimi.** Gjykata jep miratimin sa është e domosdoshme për të hetuar shkelje të ndëshkueshme dhe veçmas për secilin rast. Miratimi përshkruan sakt njeriun dhe vendin që kontrollohen, sendet që merren, dhe të dhënat që ruhen.

Neni 11. Liria vetjake

1. **Besa.** Çdonjërit i takon besa për lirinë dhe sigurinë vetjake.
2. **Heqja.** Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse sipas ecurisë ligjore kur:
 - (1) dënohet me burg për shkelje të ndëshkueshme;³¹

29 Shih, p.sh., Kusht. Malit të Zi (2007), neni 43.2.

30 Me ndryshime të vogla, kufizimin e ruajtjes së të dhënave sipas këtij neni e ka propozu Richard Stallman, programer dhe filozof amerikan që përkrah lirinë individuale në epokën digjitale. Shih Richard Stallman, «Sugjerime për kushtetutat e vendeve», në sajtin personal, www.stallman.org/articles/constitution-suggestions.al.html.

31 Skajëza shkelje e ndëshkueshme është përdorë me kuptimin e veprës penale. Meqë një shkelje e tillë kryhet me veprim edhe me mosveprim, është më saktë me thënë shkelje e ndëshkueshme. Shih G. Mjeku, «Kur „i njëjti“ kryen „vepër penale“», *Plisi.org*, 19.2.2016, plisi.org/?p=4307. Por e drejta jonë njez edhe shkelje të tjera të ligjit që mund të ndëshkohen por nuk cilësohen vepra penale.

- (2) shpërfill urdhrin e gjykatës;
 - (3) duhet mbajtë në paraburgim;
 - (4) duhet përligjë derisa hyn ose largohet nga vendi;
 - (5) rrezikon të tjerët shkaku i shëndetit; ose
 - (6) duhet kujdesë për të shkaku i shëndetit ose moshës.
3. **Borxhi.** Askujt nuk mund t'i hiqet liria pse nuk është në gjendje me la borxh ose me përmbushë detyrim kontrate.
 4. **Njoftimi.** Çdonjëri që i hiqet liria njoftohet menjëherë për ngarkesën³² ndaj tij dhe i mundësohet ndihma e avokatit.
 5. **Paraburgimi.** Njëri mund të mbahet në paraburgim:
 - (1) nën dyshim të mbështetur se ka kry shkelje të ndëshkueshme;
 - (2) në pritje të gjykimit për shkeljen e dyshuar; dhe
 - (3) nëse rrezikon të arratiset, të ndërhyjë në drejtësi, të dëmtojë të tjerët, ose të prishë rendin botor.³³
 6. **Para gjyqtarit.** Çdonjëri që i hiqet liria pa urdhër gjyqësor sillet para një gjyqtari brenda 48 orëve. Gjyqtari vendos brenda ditës a me e liru apo paraburgu.

Neni 12. Drejtësia

1. **Gjykimi i ndershëm.** Çdonjërit i takon gjykimi i ndershëm me i përcaktu të drejtat e detyrimet qytetnore³⁴ dhe përgjegjësinë për shkelje të ndëshkueshme. Gjykimi i ndershëm përfshin shqyrtimin:
 - (1) e hapur, të drejtë, dhe të paanshëm;
 - (2) brenda një afati të arsyeshëm;

Të tilla janë kundërvajtjet. Kjo çështje mund të kërkojë shqyrtim të mëtejme.

32 Akuzën. Gjithashtu, *ngarkoj* dmth. akuzoj.

33 *Buzadji k. Moldavisë*, 23755/07, GjEDNj [DhM], Aktgjyk., 5.7.2016, para. 88.

34 Termi *qytetnore* domethënë civile. At Shtjefën Gjeçovi përdorte skajëzat *qytetnore* dhe *ndëshkimitare*. Shih librin I të Kanunit të Lekë Dukagjinit (Provinçjalati Françeskan: Shkodër, bot. 1, 1933), plisi.org/?p=1330. Por përveçse për ta nderu traditën, nuk ka ndonjë shkas detyrues me thënë *qytetnore* në vend se *civile*.

- (3) nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, dhe e themeluar me ligj; dhe
- (4) të përmbyllur me aktgjykim që jepet i arsyetuar dhe shpallet haptazi.³⁵
2. **Qasja.** Çdonjëri ka të drejtë me kërku para gjykatës zhdëmtim të efektshëm kur i cenohen të drejtat ligjore.
3. **Ndihma.** Avokati, ndihma juridike, dhe përkthyesi i mundësohen falas çdonjërit që nuk ka mjete të mjaftueshme me pagu, nëse është e domosdoshme për qasje të efektshme në drejtësi.
4. **Avokatia.** Avokatët ushtrojnë profesionin mëvetësisht sipas ligjit.
5. **Të ngarkuarit.** Askush nuk mund të gjykohet për shkelje të ndëshkueshme pa pasë kohë e mjete të mjaftueshme me përgatitë mbrojtjen. Të ngarkuarit i takon:
- (1) ndihma e efektshme e avokatit dhe përkthyesit;
- (2) provat e pafajësisë;
- (3) me i marrë në pyetje e provë dëshmitarët; dhe
- (4) me i detyru dëshmitarët me u paraqitë përmes urdhrin gjyqësor.
6. **Pandehja e pafajësisë.** Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme merret i pafajshëm deri kur të dëshmohet fajtor sipas ligjit.
7. **Të ndaluara.** Askush nuk mund:
- (1) të shpallet fajtor për veprim ose mosveprim që kur ka ndodhë nuk ka qenë shkelje të ndëshkueshme sipas ligjit;
- (2) të shpallet fajtor sipas të dhënave të mbledhura paligjshëm;
- (3) të shtrëngohet me pranë fajësinë ose me dëshmu kundër vetes;
- (4) të gjykohet as ndëshkohet dy herë nën tagrin e të njëjtit shtet për të njëjtën shkelje, përveçse kur një gjykatë më e lartë urdhëron rigjykimin e çështjes; ose

35 Pika (4) mund të vihet si paragraf i veçantë i formuluar kështu: «Aktgjykimi jepet i arsyetuar dhe shpallet haptazi».

- (5) të ndëshkohet me dënim më të rëndë se ç'ka qenë e paraparë kur është kryer shkelja ose me dënim në shpërpjesëtim me rëndesën e shkeljes.
8. **Dorëzimi shtetit të huaj.** Askush nuk mund t'i dorëzohet kundër vullnetit të vet një shteti të huaj, nëse rrezikon:
- (1) të ndëshkohet për veprim ose mosveprim që nuk përbën shkelje të ndëshkueshme sipas ligjeve të Shqipërisë;
 - (2) të vuajë dënim më të rëndë nga ç'parashohin ligjet e Shqipërisë; ose
 - (3) t'i nënshtrohet një ecurie ligjore ose dënimi në kundërshtim me të drejtat themelore.
9. **Viktimat.** Çdonjëri që sipas ligjit është viktimë e një shkeljeje të ndëshkueshme ka të drejtë:³⁶
- (1) të mbrohet përmes masave të duhura ndaj të ngarkuarit;
 - (2) të njoftohet rreth rastit dhe për ikjen ose lirimit e të ngarkuarit;
 - (3) të marrë pjesë në ecurinë ligjore ndaj të ngarkuarit; dhe
 - (4) të kërkojë dëmshpërblim nga i ngarkuari.

Neni 13. Shtetësia

1. **Qytetarët e shteteve.** Qytetarët e një shteti të Besëlidhjes janë njëherësh qytetarë shqiptarë.
2. **Me të lindur.** Çdo njeri i lindur në Shqipëri ose që ka prind a gjysh shqiptar është vetiu qytetar shqiptar.
3. **Me të fituar.** Qytetar mund të bëhet kushdo që përmbush kushtet e përcaktuara me ligj dhe njeh kënaqshëm gjuhën shqipe.
4. **Të ndaluara.** Asnjë qytetari nuk mund t'i mohohet ose t'i hiqet e drejta e shtetësisë. Asnjë qytetar nuk mund:
 - (1) të pengohet me hy në Shqipëri;
 - (2) të dëbohet nga Shqipëria; ose

36 Shih, p.sh., Kushtetutën e Alaskës (ShBA, 1956/1994), neni I.24.

(3) t'i dorëzohet kundër vullnetit të vet një shteti të huaj, përveç nëse me marrëveshje ndërkombëtare përcaktohet ndryshe.

5. **Mbrojtja.** Besëlidhja mbron me ligj interesat e qytetarëve jashtë Shqipërisë.

Neni 14. Lëvizja

1. **Në përgjithësi.** Qytetarët dhe banorët e ligjshëm kanë të drejtë me lëvizje dhe me zgjedhje vendbanimin lirshëm.
2. **Largimi.** Çdonjëri ka të drejtë me u largu nga Shqipëria.
3. **Të huajt.** Me ligj rregullohet e drejta e të huajve me hy dhe me qëndru në Shqipëri.
4. **Ndorja.** Shqipëria u jep ndorje të huajve që në vendet e tyre u kanë noset përndjekja shkakut i prejardhjes, fesë, mendimit politik, shoqërim, ose gjendjeje a vetie tjetër.

Neni 15. Liria shpirtërore

1. **Në përgjithësi.** Çdonjërit i takon liria e mendimit, ndërgjegjes, dhe fesë. Çdonjëri ka të drejtë ta zgjedhë, ndërrojë, fshehë, ose shprehë mendimin a fenë e vet.
2. **Bashkësitë.** Bashkësitë fetare rregullojnë mëvetësisht organizimin e brendshëm dhe ritet.

Neni 16. Liritë qytetare

1. **Shprehja.** Çdonjërit i takon liria e shprehjes, që përfshin njoftimin, botimin, dhe kumtimin.
2. **Korrigjimi.** Çdonjëri ka të drejtë sipas ligjit të korrigjojë botimin e pasaktë a të paplotë që ia cenon të drejtat a interesat.
3. **Tubimi dhe shoqërimi.** Çdonjërit i takon liria e tubimit paqësor dhe shoqërimin.

Neni 17. Demokracia

1. **Zgjedhjet.** Çdo qytetar që ka mbushë 18 vjet ka detyrë me qitë votën e vet dhe të drejtë me zgjedhë dhe me u zgjedhë përfaqësues, përveç nëse me urdhër të prerë i hiqet zotësia për të vepruar ose Kushtetuta përcakton ndryshe. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë, dhe e fshehtë.
2. **Barazia gjinore.** Për sa është e mundshme, burrat dhe gratë duhet të përbëjnë të paktën nga një të tretën e çdo organi shumanëtarësh të shtetit ose ndërmarrjeve në pronësi botore.³⁷ Zgjedhja që bëjnë qytetarët mund të shpërfilllet sa është e domosdoshme për këtë qëllim.
3. **Ndikimi.** Çdo qytetar ka të drejtë t’u parashtrojë kërkesë autoriteve botore dhe të ndikojë demokratikisht në vendimmarrje.
4. **Shpenzimet.** Ligji mund të kufizojë shpenzimet private që kanë qëllim të ndikojnë në zgjedhje, dhe mund t’u kërkojë shpenzuesve të mëdhenj të identifikohen.³⁸
5. **Detyra botore.** Askush nuk mund të përdorë detyrën botore për t’i shërby interesit të veçantë të vetes ose të të afërmeve. Ligji mund t’ua kufizojë ish-zyrtarëve shtetërorë ose ish-zyrtarëve të ndërmarrjeve në pronësi botore pjesëmarrjen për kohë të arsyeshme në veprimtari ekonomike që:
 - (1) kanë pasë detyrë t’i rregullojnë ose mbikëqyrin; ose
 - (2) kanë qëllim të ndikojnë në punën e shtetit ose të ndërmarrjeve në pronësi botore.³⁹

37 Mbiemri *botor* ka kuptimin e mbiemrit *publik* kudo në këtë projekt.

38 Shpenzimet e pakufizuara në fushata zgjedhore janë bërë temë kyçe në ShBA, veçmas pas vendimit të Gjykatës Supreme në rastin *Citizens United v. FEC*, 558 U.S. 310 (2010). Senatori Bernie Sanders ka paraqitë propozim për ndryshimin e kushtetutës federative për të kufizuar shpenzimet. Shih kumtesën shtyp «Sanders Files Constitutional Amendment to Overturn Supreme Court’s Citizens United Decision», 21.1.2015, bit.ly/2Z5JemP.

39 Disa shtete amerikane parashohin me kushtetutë ose ligj ndalimin e derës rrotulluese (*revolving door*). National Conference of State Legislatures, «Revolving Door Prohibitions», 3.4.2019, bit.ly/2nfCELG. Stallmani rekomandon kufizim deri në 10 vjet. Shih shënimin 30, sipër.

6. **Qëndresa.** Çdo qytetar ka të drejtë t'i bëjë qëndresë kujtdo që përpiqet ta përmbysë rendin kushtetutor kur qytetari nuk ka mundësi tjetër me mbrojtë rendin.⁴⁰
7. **Dokumentet.** Çdonjërit i takon e drejta e qasjes në dokumente botore.

Neni 18. Familja

1. **Në përgjithësi.** Shteti mbron familjen dhe ndihmon prindërit me rritë dhe eduku fëmijët. Çdo prindi të punësuar i takon pushimi i lehonisë me pagesë, para dhe pas lindjes së fëmijës.
2. **Martesa.** Dy veta të moshës martesore që nuk janë në lidhje gjaku kanë të drejtë të martohen dhe krijojnë familje me pëlqim të lirë. Martesa dhe prishja e saj rregullohen me ligj dhe mbështeten në barazinë e bashkëshortëve.
3. **Fëmijët.** Çdo fëmije i takon kujdesi për mirëqenie dhe mbrojtja nga dhuna, keqtrajtimi, e shfrytëzimi. Vendimet rreth fëmijës duhet të jenë në interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 19. Prona

1. **Në përgjithësi.** Çdonjëri ka të drejtë ta gëzojë paqësisht pronën e vet.
2. **Shpronësimi.** Shteti mund t'ia marrë pronën dikujt sa është e domosdoshme për të mbërrirë qëllim botor, por duhet t'ia paguajë vlerën që prona ka në treg.
3. **Plangu.** Çdonjëri ka të drejtë të shfrytëzojë plangun. Përbën plang prona që e përdor për banim ose bujqësi mbijetese pronari, bashkëshorti, prindi, ose fëmija i mitur të pronarit. Askujt nuk mund t'i merret plangu përveçse në rastet e përcaktuara me ligj.⁴¹

40 Ligji Themelor i Gjermanisë (1949/2014), neni 20.4.

41 Kusht. Floridës (ShBA, 1968), neni X.4; Kusht. Teksasit (ShBA, 1879/2017), neni 8; Kodi i pronës i Teksasit, *Tex. Prop. Code* (bot. 2017), § 11.13.

Neni 20. Puna dhe mirëqenia

1. **Puna.** Çdonjëri ka të drejtë të punojë dhe zgjedhë lirshëm zanatin e vendin e punës. Shteti nxit punësimin e qytetarëve.
2. **Punonjësit.** Punonjësit i takojnë kushte të denja dhe të sigurta për punë, përfshi orarin e arsyeshëm dhe pushimin vjetor të paguar. Punonjësit kanë të drejtë të organizohen dhe të grevojnë për t'i mbrojtë interesat e tyre.
3. **Ndihma.** Çdonjërit i takon ndihma e shoqërisë për jetesë të denjë. Ligji rregullon kujdesin shëndetësor dhe sigurimin themelor për rastet e papunësisë, sëmundjes, aftësisë së kufizuara, dhe moshës së shtyrë.

Neni 21. Zhvillimi

1. **Në përgjithësi.** Çdonjërit i takon e drejta e zhvillimit, përfshi të drejtën:
 - (1) me gëzu shëndetin dhe me zhvillu shqisën dhe mendjen;
 - (2) me kërkim lumturinë vetë dhe si pjesëtar i shoqërisë; dhe
 - (3) me përfitim nga të mirat e artit, shkencës, teknologjisë, dhe përparimit të gjithëmbarshtëm njerëzor.
2. **Arsimi.** Çdonjëri ka të drejtë të arsimohet falas dhe detyrë të ndjekë arsimin e domosdoshëm të përcaktuar me ligj. Shteti siguron për çdonjërin mundësi me u arsimu sipas aftësive dhe nevojave të posaçme.
3. **Puna mendore.** Çdonjërit i takon liria e punës mendore, që përfshin punën akademike, hulumtimin shkencor, shpikjet e risimet, dhe krijimtarinë artistike e letrare. Ligji i jep autorit dhe shpikësit privilegje për ta nxitë botimin e veprës ose idesë dhe për t'u mundësuar të tjerëve me përdorë atë.⁴²
4. **Sipërmarrësia e konsumatorët.** Çdonjëri ka të drejtë të zhvillojë dhe investojë në sipërmarrësi të vyeshme, dhe konsumatori ka të drejtë ta kërkojë hakun për mallin dhe shërbimin. Shteti mbron

42 Mbështetë në vështrimin e Stallmanit mbi qëllimin e së drejtës së autorit dhe patentave. Shih R. Stallman, shënimi 20, sipër.

investuesin, konkurrencën e lirë, konsumatorin, dhe huamarrësin sipas ligjit.⁴³

5. **Softveri.** Askush nuk mund të detyrohet të përdorë ose të blejë softver për të gëzuar të drejtat e veta, nëse nuk mund të qasë, ndryshojë, ose botojë ndërtimin e brendshëm të softverit.⁴⁴
6. **Veglat.** Përveçse kur pajtohet ndryshe përmes negocimit individual, çdonjëri ka të drejtë:
 - (1) të ndreqë veglën që ka në pronësi; dhe
 - (2) të studiojë funksionimin e një vegle që ka në zotërim dhe të botojë atë që mëson rreth veglës.⁴⁵

Neni 22. Mjedisi dhe pasuritë

1. **Mjedisi.** Çdonjëri ka të drejtë ta gëzojë dhe detyrë ta mbrojë mjedisin jetësor, që përfshin natyrën, gjithllojshmërinë e gjallesave, dhe trashëgiminë kombëtare e kulturore. Gjatë vendimmarrjes, organet shtetërore kanë parasysh ndikimin në mjedisin jetësor.
2. **Pasuritë.** Populli ka të drejtë të gëzojë pasuritë natyrore. Ato përfshijnë ujërat, hapësirën ajrore, burimet minerare, tokën, pyjet, botën bimore e shtazore, dhe të tjera të mira të përcaktuara me ligj. Rregullohen me ligj kufizimet e të drejtave mbi pasuritë natyrore dhe kompensimi për kufizimet e tilla.

43 Një draft i mëhershëm i projektit ka radhitë kundrinat në shumës: «investuesit [...], konsumatorët, dhe huamarrësit [...]». Por shumësi do të mund t'ia zbehte efektin dispozitës. A mbrohet të gjithë investuesit në përgjithësi apo veç e veç? A ka të drejtë një investues i vetëm të kërkojë të drejtën e vet në gjykatë? Ekspertët e shkrimit juridik parapëlqejnë njëjësin. Bryan A. Garner, *Legal Writing in Plain English: A Text with Exercises*, 2d ed. (Chicago UP, 2013), f. 135, § 38.

44 Kjo dispozitë promovon softverin e lirë (*free software*), të njohur edhe si softver i lirë dhe kod-hapur (*free and open source software*). Nuk gjendet në asnjë kush-tetutë. Shih FSF, «Ç'është software-i i lirë?», www.gnu.org/philosophy/free-sw.sq.html.

45 Stallman, shënimi 20, sipër.

Neni 23. Shpenzimet botore

1. **Të drejtat.** Çdo qytetar ka të drejtë të gëzojë frytet e shpenzimeve të shtetit.
2. **Detyrimet.** Çdonjëri nën tagrin e Shqipërisë ka detyrë t'i paguajë tatimet dhe detyrimet financiare të përcaktuara me ligj.
3. **Prajshmëria.** Shteti mbledh, huazon, dhe shpenzon mjete pasurore sipas ligjit, haptazi, dhe sa më vyeshtë.⁴⁶ Organet shtetërore japin llogari për shpenzimet e tyre.

Neni 24. Komunitetet

1. **Në përgjithësi.** Komuniteti është grup kombëtar ose fetar tradicionalisht i pranishëm në Shqipëri. Çdo komunitet ka të drejtë të ruajë dhe zhvillojë gjuhën dhe kulturën e vet.⁴⁷
2. **Ndihma.** Shteti i mundëson komunitetit:
 - (1) shkollimin fillor dhe të mesëm në gjuhët e vet; dhe
 - (2) përfaqësim të denjë në ngrehimet⁴⁸ botore dhe ndërmarrjet në pronësi botore.

Neni 25. Kufizimet

1. **Në përgjithësi.** Një e drejtë themelore nuk mund të kufizohet pos me ligj sa është e domosdoshme për ta mbrojtë rendin kushtetutor.
2. **Thelbi.** Kufizimi i një të drejte themelore nuk mund ta mohojë thelbin e saj ose të tejkalojë kufizimet e lejuara nga instrumentet ndërkombëtare të cekura në Kushtetutë.

46 Ndajfolja *vyeshëm* është përdorë këtu me kuptimin *në mënyrë efçiente* (ang. *efficiently*). Efçienca nënkupton me bë më shumë me më pak.

47 Alternativë: «Komunitetet janë grupe [...]. Kanë të drejtë [...]». Shih shënimin 43, sipër.

48 Emri *ngrehim* është përdorë me kuptimin institucion. Pra, ngrehim botor domethënë institucion publik. Shih dhe shënimin 26, sipër.

3. **Shqyrtimi.** Kur kufizohet një e drejtë themelore, organet shtetërore shqyrtojnë mundësinë me arritë qëllimin me kufizim më të vogël duke u kushtuar vëmendje:
 - (1) thelbit të së drejtës që kufizohet;
 - (2) rëndësisë së qëllimit të kufizimit;
 - (3) natyrës dhe vëllimit të kufizimit; dhe
 - (4) përputhjes mes kufizimit dhe qëllimit të kufizimit.
4. **Gjykata Evropiane.** Të drejtat e përcaktuara me këtë krye interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kreu III Prijetari

Neni 26. Përcaktimi

1. **Në përgjithësi.** Prijetari⁴⁹ është kreu i Besëlidhjes. Ai përfaqëson njëshmërinë e popullit dhe ruan demokracinë.
2. **Tagri.** Prijetari ka tagër:
 - (1) ta përfaqësojë Shqipërinë;
 - (2) të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare;
 - (3) të pranojë diplomatët e huaj;
 - (4) të dërgojë në këshillim me Qeverinë diplomatë e konsuj të Shqipërisë në shtetet e huaja;
 - (5) të japë pëlqimin për emërimin e zyrtarëve kur kërkohet me ligj;
 - (6) të japë medalje, mirënjohje, dhe çmime;

49 Alternativë: *Presidenti*, fjalë në përdorim të tanishëm, ose *Kryetari i Besëlidhjes*. Shih dhe shkrimin tim, «Gjuha e Kushtetutës: President apo Kryetar», botu në *Telegrafi.com*, 30.5.2011, plisi.org/?p=96.

- (7) të shpallë falje individuale sipas ligjit;
- (8) t'i drejtohet Kuvendit të Madh rreth gjendjes së vendit dhe veprimtarisë së Prijetarit, të paktën një herë në vit; dhe
- (9) të bartë përgjegjësi të tjera të parapara me Kushtetutë.

Neni 27. Zgjedhja

1. **Në përgjithësi.** Prijetarin e zgjedhin qytetarët. Zgjedhjet mbahen çdo 6 vjet dhe kur zyra e Prijetarit mbetet e lirë.
2. **Kushtet.** Mund të zgjedhet Prijetar çdo qytetar që ka mbushë 30 vjet.⁵⁰ Mund të kandidohet çdo qytetar që ka përkrahjen e 3-mijë qytetarëve. I njëjti qytetar mund të zgjedhet tri herë.
3. **Votimi i parë.** Votuesi mund ta miratojë, kundërshtojë, ose shpërfillë secilin kandidat veç e veç. Për çdo herë që miratohet, kandidati merr një pikë, dhe për çdo herë që kundërshtohet, i hiqet një pikë. Zgjedhet Prijetar kandidati që ka gjithsej më së shumti pikë dhe e miratojnë mbi gjysma e të gjithë votuesve.⁵¹

50 Kandidati duhet të ketë mbushë 30 vjet ditën e zgjedhjeve. Kushtetuta e tanishme e Kosovës vë si kusht moshën 35 vjeç, kurse Shqipëria kërkon 5 vjet më shumë. Kusht. Ksv. (2008/2016), neni 85; Kusht. Shqip. (1998/2016), neni 86.2. Por ky kufizim është arkaik. Ndër kushtetuta të shkruara, shfaqet në kushtetutën amerikane, të hartuar më 1789, që përcakton kushte të ngjashme edhe për përfaqësuesit dhe senatorët: moshën 25 dhe 30 vjeç. Kusht. ShBA (1789/1992), nenet I.2.2, I.3.3, dhe II.1.5. Për kohë të gjatë në ShBA, moshja madhore dhe e drejta e votës është arritë me 21 vjet. Shih amend. XXVI (1971).

Projekti nuk kërkon as që kandidati të ketë qenë shtetas që nga lindja ose të ketë banu në vend për një periudhë të caktuar. Shih Kusht. Ksv., neni 85; khs. me Kusht. Shqip, neni 86.2; Kusht. ShBA, neni II.1.5. Nëse kreu i shtetit zgjedhet nga populli, votuesit do të mund ta filtrojnë listën e kandidatëve më mirë se kualifikimet formale.

51 Kjo është mënyrë e veçantë e zgjedhjes që është përdorë historikisht ndër republika, por sot nuk haset në zgjedhjen e kreut të shtetit në asnjë vend. Megjithatë, ia vlen me e shqyrtu si mundësi që favorizon kandidatët më të moderuar e më konsensualë. Shih shkrimin tim, «Me votu plot kandidatë», *DialogPlus*, 4.11. 2016, dialogplus.ch/me-votu-plot-kandidate-121890.

Si alternativë, votimi klasik me dy runde mund të përcaktohet kështu:

- *Zgjedhja.* Zgjedhet Prijetari kandidati që merr mbi gjysmën [shumicën] e votave të vlefshme.
- *Dytësimi.* Nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën e votave të vlefshme, mbahet një votim dytësues të dielën e dytë pas votimit të parë. Votuesi

4. **Dytësimi.** Nëse asnjë kandidat nuk zgjedhet Prijetar, mbahet votimi dytësues të dielën e dytë pas votimit të parë. Votuesi zgjedh njërin nga dy kandidatët që kanë marrë më së shumti pikë në votimin e parë. Zgjedhet Prijetar kandidati që merr shumicën e votave të vlefshme.

Neni 28. Mandati

1. **Kohëzgjatja.** Prijetari nis mandatin pasi betohet. Qëndron në detyrë deri kur të betohet pasuesi, përveç nëse dorëhiqet, shkarkohet, ose vdes.
2. **Papajtueshmëria.** Prijetari nuk mund të ushtrojë detyrë tjetër botore ose të jetë anëtar i një partie politike.
3. **Mungesa.** Kryetari i Pleqësisë ushtron detyrën e Prijetarit aq kohë sa:
 - (1) zyra e Prijetarit mbetet e lirë;
 - (2) Prijetari ia jep detyrën; ose
 - (3) dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit të Madh vlerësojnë se Prijetari nuk është në gjendje me ushtru detyrën.⁵²

Neni 29. Shkarkimi

1. **Rastet.** Prijetari mund të shkarkohet nëse:
 - (1) nuk do të jetë në gjendje me ushtru detyrën mbi 6 muaj shkak i sëmundjes;
 - (2) është dënuar për krim të rëndë; ose
 - (3) ka shkelë rëndë Kushtetutën.
2. **Kërkesa.** Kërkesën për ta shkarkuar Prijetarin ia paraqesin Kuvendit një e treta e anëtarëve të njëjës dhomë, duke cekë arsyen për shkarkim.

zgjedh njërin nga dy kandidatët që kanë marrë më së shumti vota në votimin e parë.

52 Alternativë: «nuk është në gjendje me i përmbushë përgjegjësitë».

3. **Pyetja.** Nëse kërkesa cek sëmundjen, Kuvendi pyet një këshill mjekësor për gjendjen e Prijetarit. Nëse kërkesa pandeh se Prijetari e ka shkelë rëndë Kushtetutën, Kuvendi pyet Gjykatën e Naltë. Këshilli mjekësor ose Gjykata e Naltë përgjigjet brenda 14 ditëve.
4. **Votimi.** Kuvendi i Madh shqyrton përgjigjen e këshillit mjekësor ose Gjykatës së Naltë, dhe shkarkon Prijetarin me dy të tretat e deputetëve.
5. **Pasojat.** Prijetari i shkarkuar pse është dënuar për krim të rëndë ose ka shkelë rëndë Kushtetutën nuk mund të zgjedhet ose të emërohet në detyrë botore pa kaluar 5 vjet.⁵³

Kreu IV Kuvendi

Neni 30. Përcaktimi

1. **Në përgjithësi.** Kuvendi ushtron pushtetin ligjvënës të Besëlidhjes.
2. **Përbërja.** Kuvendin e përbëjnë dy dhoma:
 - (1) Logu Popullor me 90 deri në 120 logtarë; dhe
 - (2) Pleqësia me 40 deri në 60 pleqnarë.
3. **Tagri.** Kuvendi ka tagër:
 - (1) të miratojë ligje dhe akte të tjera;
 - (2) të miratojë buxhetin e Besëlidhjes;
 - (3) të mbikëqyrë politikën e jashtme dhe të sigurisë;⁵⁴ dhe

53 Rreth përjashtimit nga kandidimi për post shtetëror dhe kohëzgjatjes së përjashtimit, shih rastin e ish-kryetarit lituan në Gjykatën e Strasburgut, *Paksas kundër Lituaniës*, GJEDNj 34932/04, Aktgjyk. 6.1.2011.

54 Se Kuvendi ka tagër të mbikëqyrë politikën e sigurisë e thotë me fjalë të tjera edhe Neni 49.1. Në tekstin e kushtetutës është me rëndësi mos me pasë përsërit-

- (4) të kryejë detyra të parapara me Kushtetutë e ligj.
4. **Punimet.** Dy dhomat e Kuvendit zhvillojnë punimet:
- (1) ndaras dhe paralelisht; dhe
 - (2) bashkërisht si Kuvend i Madh, në rastet e parapara me Kushtetutë.

Neni 31. Zgjedhja

1. **Orari.** Zgjedhjet për Kuvend mbahen çdo 4 vjet dhe kur shpërndahet Kuvendi.
2. **Logtarët.** Qytetarët e secilit shtet zgjedhin 30 deri në 60 logtarë. Qytetarët e secilit vis të një shteti zgjedhin dy a më shumë logtarë, në përpjesëtim me popullsinë e visit. Deri në 10 logtarë të tjerë mund të ruhen për:
 - (1) bashkësitë shqiptare jashtë Shqipërisë; dhe
 - (2) komunitetet joshumicë.
3. **Pleqnarët.** Shtetet caktojnë të paktën nga 15 pleqnarë dhe një numër shtesë në përpjesëtim me popullsinë e tyre.

Neni 32. Mandati

1. **Në përgjithësi.** Anëtarët e Kuvendit përfaqësojnë popullin.
2. **Kohëzgjatja.** Anëtari i Kuvendit nis mandatin kur betohet. Me t'u shpallë zgjedhjet, mbaron mandati:
 - (1) i të gjithë logtarëve; dhe
 - (2) gjysmës së pleqnarëve, duke filluar me ata që janë zgjedhë më së herëti, e nëse nuk mund të dihen, me ata që caktohen me short.
3. **Para kohe.** Mandati mbaron para kohe nëse anëtari i Kuvendit:
 - (1) dorëhiqet;
 - (2) mungon 6 muaj rresht pa leje nga mbledhjet e Kuvendit;
 - (3) ushtron detyrë të ndaluar;

je, andaj pjesa «dhe të sigurisë» mund të hiqet.

- (4) dënohet me një vit burg me vendim të prerë; ose
 - (5) vdes.
4. **Papajtueshmëria.** Anëtari i Kuvendit nuk mund:
- (1) të jetë anëtar i të dy dhomave në të njëjtën kohë;
 - (2) të ushtrojë detyrë drejtuese në organe shtetërore ose ndërmarrje në pronësi botore; ose
 - (3) të përfshihet në veprimtari që mund t'i ndalohen me ligj.
5. **Zbrazëtia.** Vendi i lirë i logtarit plotësohet sipas ligjit. Vendi i lirë të pleqnarit e plotëson shteti.
6. **Shpërndarja.** Mund ta shpërndajnë Kuvendin:
- (1) dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit të Madh, kur e shohin të vyeshme; ose
 - (2) Prijetari, në rastet e parapara me Kushtetutë.

Neni 33. Kryesia

- 1. **Në përgjithësi.** Dhoma emëron kryesinë e vet nga radhët e të paktën tri togjeve më të mëdha të anëtarëve.
- 2. **Përbërja.** Kryesinë e dhomës përbëjnë kryetari dhe 3 deri në 5 nënkryetarë.
- 3. **Emërimi.** Anëtarët e kryesisë emërohen me shumicën e anëtarëve të dhomës dhe shkarkohen me praninë e dy të tretave.
- 4. **Kuvendi i Madh.** Kryetari i Logut Popullor, kryetari i Pleqësisë, dhe një anëtar i tretë e përbëjnë bashkërisht kryesinë e Kuvendit të Madh. Anëtari i tretë është anëtar i më i moshuar i Kuvendit, përveç nëse dy kryetarët vendosin ndryshe.

Neni 34. Puna

- 1. **Orari.** Kuvendi mbledhet të paktën dy herë në vit: të hënën e tretë të janarit dhe të hënën e dytë të shtatorit. Mbledhjet e jashtëzakonshme mbahen me kërkesën e Prijetarit ose të një të tretës së anëtarëve të njërës dhomë.

2. **Kuorumi.** Dhoma ose Kuvendi i Madh nuk mund të zhvillojë punimet pa praninë e shumicës së anëtarëve.
3. **Votimi.** Anëtarët votojnë haptazi për çdo vendim.
4. **Vendimet.** Përveç kur Kushtetuta përcakton ndryshe, Kuvendi merr vendim kur:
 - (1) shumica e anëtarëve të pranishëm në secilën dhomë votojnë për; ose
 - (2) shumica e logtarëve votojnë për, e shënjojnë vendimin për miratim pa votën e Pleqësisë, dhe bëhet një vit nga votimi.⁵⁵
5. **Mbledhjet e hapura.** Kuvendi i mban mbledhjet të hapura. Prijetari ose një e treta e anëtarëve të dhomës mund të kërkojnë mbledhje të mbyllur. Dhoma miraton kërkesën haptazi me dy të tretat e anëtarëve.
6. **Komisionet.** Dhomat ngrenë nga radhët e veta komisione për punë të posaçme. Dhoma ngre komision hetimor me kërkesën e një të tretës së anëtarëve.

Neni 35. Rregulloret

1. **Dhomat.** Dhoma miraton me dy të tretat e anëtarëve rregulloren e vet. Rregullorja përcakton organizimin e brendshëm dhe punën e dhomës, anëtarëve, kryesisë, togjeve të anëtarëve,⁵⁶ dhe komisioneve.
2. **Kuvendi i Madh.** Kuvendi i Madh miraton me dy të tretat e anëtarëve rregulloren e vet. Nëse Kuvendi i Madh nuk arrin të miratojë rregullore, e zbaton përshtatshmërisht rregulloren e Logut Popu-

55 Kjo mënyrë e vendimmarrjes mund të quhet *miratim me pritje*. Rrjedh nga koncepti i votës pezulluese (*suspensory veto*) i dhomës së lartë në Britani, ku është shfaqë më 1911. Asokohe, Dhoma e Komunëve, që zgjedhet nga populli, haste në pengesa nga Dhoma e Lordëve të pazgjedhur. Me miratimin e dy ligjeve për Parlamentin (*Parliament Act 1911* dhe *Parliament Act 1949*), u tkurr fuqia e Lordëve për të kundërshtu projektet e miratuara në dhomën e ulët.

56 Përdorë si sinonim për grupet parlamentare, por jo domosdo me kuptimin që grupi parlamentar ka në jurisprudencës e tanishme. Shih rastin KO 119/14, GjKK, Aktgjyk. 26.8.2014 (lidh grupin parlamentar me deputetët e dalë nga lista e një partie).

llor. Kryesia e Kuvendit të Madh cakton një komision ndërlidhës mes dy dhomave.

Neni 36. Ligjvënia

1. **Nisma.** Mund t'i parashtrojnë Kuvendit projektligj për shqyrtim e miratim 10 mijë qytetarë me të drejtë vote, cilido anëtar i Kuvendit, Prijetari, ose Qeveria.
2. **Prijetarit.** Pasi ta miratojë ligjin, Kuvendi ia paraqet menjëherë Prijetarit. Brenda 7 ditëve, Prijetari shpall ose kthen ligjin në Kuvend për rishqyrtim dhe cek pse po e kthen.
3. **Shpallja ose kthimi.** Nëse Prijetari nuk e shpall ose kthen ligjin, ligji vetëshpallet 7 ditë pasi i paraqitet Prijetarit. Nëse Prijetari e kthen ligjin, Kuvendi mund ta rimiratojë pa e ndryshuar dhe ta shpallë vetë me tri të pestat e anëtarëve të secilës dhomë.
4. **Në fuqi.** Ligji botohet brenda 14 ditëve pasi shpallet, dhe hyn në fuqi 14 ditë pasi botohet, përveç nëse vetë përcakton ndryshe.

Neni 37. Marrëveshjet ndërkombëtare

1. **Njoftimi.** Kuvendi njoftohet sa herë nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.
2. **Në Kuvend.** Ratifikohet në Kuvend çdo marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë me miratimin e ligjeve.
3. **Me dy të tretat.** Ratifikohet me dy të tretat e anëtarëve të secilës dhomë marrëveshja ndërkombëtare që ka të bëjë me:
 - (1) truallin, paqen, aleancat, ose çështjet politike a ushtarake;
 - (2) të drejtat themelore;
 - (3) anëtarësimin në organizata ndërqeveritare; ose
 - (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare.
4. **Nga Prijetari.** Marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i ratifikon Prijetari.
5. **Shqyrtimi gjyqësor.** Prijetari ose një e pesta e anëtarëve të njëjës dhomë mund t'i kërkojnë Gjykatës së Naltë ta shqyrtojë marrëve-

shje ndërkombëtare para se të ratifikohet. Brenda 30 ditëve, Gjykata e Naltë parandalon ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare që është në kundërshtim me Kushtetutën.

Kreu V

Qeveria

Neni 38. Përcaktimi

1. **Në përgjithësi.** Qeveria⁵⁷ ushtron pushtetin përmbarues të Besëlidhjes.
2. **Përbërja.** Qeverinë e përbëjnë Kryeministri dhe 6 deri në 9 ministra.
3. **Tagri.** Qeveria ka tagër:
 - (1) të zbatojë ligjet dhe aktet e tjera të Kuvendit;
 - (2) të paraqesë dhe zbatojë politikën e brendshme dhe të jashtme;
 - (3) të marrë vendime dhe të nxjerrë rregullore e udhëzime të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
 - (4) të paraqesë buxhetin e Besëlidhjes;
 - (5) të bartë përgjegjësi të tjera të parapara me Kushtetutë e ligj; dhe
 - (6) të bartë përgjegjësitë përmbaruese që nuk u janë caktuar organeve të tjera.
4. **Kryeministri.** Kryeministri udhëheq Qeverinë dhe siguron zbatimin e politikave të tij.

⁵⁷ Alternativa: *Këshilli i Ministrave* ose *Kabineti*. Shih Kusht. Shqip. (1998/2016) dhe Kusht. Japon. (1946).

5. **Ministrat.** Ministri është kreu i një ministrie. Ministria bart përgjegjësi të caktuara brenda tagrit të Qeverisë, dhe ka staf meritore profesionist.

Neni 39. Emërimi

1. **Kryeministri.** Kryeministrin e emëron Kuvendi i Madh me shumicën e anëtarëve dhe me pëlqimin e Prijetarit:⁵⁸

- (1) në mbledhjen e parë pas zgjedhjeve;⁵⁹
- (2) kur zyra e Kryeministrit mbetet e lirë;⁶⁰

58 Kjo mënyrë e emërimit të kryeministrit dallon nga ecuria që tradicionalisht e hasim në sistemet parlamentare. Parimisht, kreu i shtetit emëron kryeministrin me pëlqimin e legjislativit. Mënyra e propozuar synon me thjeshtu ecurinë.

Në Itali, presidenti emëron kryeministrin, i cili duhet ta sigurojë besimin e parlamentit brenda një periudhe të caktuar. Kusht. Itali (1947/2012), nenet 92 dhe 94.

Në vende si Gjermania e Kosova, kreu i shtetit propozon kandidatin për kryeministër — ose cakton një mandatar për ta formu qeverinë e re me miratimin e parlamentit. Ligji Themelor i Gjermanisë (1949/2014), neni 63.1. Por roli i presidentit është kryesisht formal, duke qenë se ai duhet të këshillohet me partitë në Kuvend dhe ta mandatojë kandidatin e shumicën. Kusht. Ksv. (2008/2016), neni 95; rasti KO 103/14, GjKK, Aktgjyk. 1.7.2014. Nëse mandatarin i parë dështon, presidenti emëron një mandatar të dytë. Kusht. Ksv., neni 95.4.

Në Shqipëri, presidenti emëron kryeministrin me propozimin e partisë ose koalicionit që ka shumicën në Kuvend. Kusht. Shqip. (1998/2016), neni 96.1. Kryeministri i emëruar ia paraqet Kuvendit përbërjen dhe programin e qeverisë për miratim brenda 10 ditësh. Nenet 96.2 dhe 97. Nëse Kuvendi nuk e miraton, presidenti emëron kryeministër tjetër. Neni 96.3. Nëse dështon edhe kryeministri i dytë, atëherë vetë Kuvendi e cakton kryeministrin, ndërsa presidenti e emëron formalisht. Neni 96.3; shih dhe Kusht. Estonisë (1992/2015), neni 89.

Disa monarki parlamentare paraqesin model të veçantë. Në Suedi, mandatarin e cakton kryetari i parlamentit; kurse kreu i shtetit merr pjesë vetëm në ceremoninë e betimit. Ligji i Qeverisjes i Suedisë (1974/2012), kap. VI, nenet 2–4, 6.

Në Japoni, kryeministrin e cakton vetë organi ligjvënës, dhe perandori ka për detyrë ta emërojë (formalisht). Kusht. Japon. (1946), neni 6.

Ky projekt propozon që njëherë të votojë Kuvendi, e pastaj ta japë pëlqimin kreu i shtetit. Në njërën anë, i afrohet modelit të Suedisë e Japonisë; në anën tjetër, lejon që kreu i shtetit ta shkagojë (refuzojë) kandidatin që zgjedh Kuvendi për shkaqe legjitime. Falë kësaj kompetence, Prijetari mund të ndikojë drejtpërdrejt në zgjedhjen që bën Kuvendi.

59 Siç ndodh rëndom në një demokraci parlamentare, por dhe në republika gjysmë-presidenciale, kryeministri emërohet menjëherë pas zgjedhjeve për legjislativin.

(3) sa herë të jetë e nevojshme;⁶¹ ose

(4) sa herë ta shohë të vyeshme.⁶²

2. **Propozimi.** Emërimin e Kryeministrit mund ta kërkojnë një e treta e anëtarëve të njërës dhomë të Kuvendit duke paraqitë kandidatin.⁶³ Kuvendi i Madh voton brenda 3 ditëve. I njëjti anëtar i Kuvendit mund ta kërkojë emërimin e Kryeministrit një herë në muaj.⁶⁴
3. **Ministrat.** Ministrat i emëron Kryeministri me pëlqimin e Prijetarit.

60 Kjo pikë nënkuptohet nga pika vijuese («kur të jetë e nevojshme»). Alternativisht, mund të hiqet krejt.

61 Emërimi i një kryeministri të ri mund të nevojitet për arsye të ndryshme: kryeministri jep dorëheqje, vdes, ose për arsye tjetër nuk është në gjendje të përmbushë përgjegjësitë. Këto raste mund t'i përshkruajmë në këtë dispozitë si «sa herë të jetë e nevojshme». Në alternativë mund t'i cekim një nga një, siç bëjmë te Neni 28.3 për Prijetarin. Natyrisht, mungesa e kryeministrit nuk paraqet të njëjtat shqetësime si mungesa e Prijetarit, meqë detyrën e kryeministrit mund ta ushtrorë njëri nga ministrat (Neni 40.4).

62 Kjo nënkupton votën e mosbesimit, përmes së cilës legjislativi detyron dorëheqjen e ekzekutivit në një demokraci parlamentare. Por fjala është për votëbesim konstruktiv, që i lejon Kuvendit të largojë kryeministrin e tashëm por i kërkon ta votojë pasuesin e tij. Shih Kusht. Shqip. (1998/2016), neni 105. (Përfashtim bën rasti kur dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit të Madh vendosin me shpërnda Kuvendin, siç parasheh Neni 32.6) Për thjeshtësi, termat *votëbesim*, *votë mosbesimi* ose *mocion votëbesimi* nuk janë përdorë në dispozitat e këtij projekti.

63 Propozimi nënkupton propozimin fillestar të kandidatin menjëherë pas zgjedhjeve ose mocionin e votëbesimit gjatë mandatit të Kuvendit dhe kryeministrit. Prandaj është thënë «emërimin e Kryeministrit» dhe jo «emërimin e një kryeministri të ri».

Për dallim nga kushtetutat e tashme të Shqipërisë e Kosovës, kryeministri nuk mund ta kërkojë vetë votëbesimin. Kusht. Shqip. (1998/2016), neni 104.1; Kusht. Ksv. (2008/2016), neni 100.2. Nëse kryeministri nuk do të shërbejë, mund të japë dorëheqje; Kuvendi do ta emërojë pastaj kryeministrin e ri. Por meqë ky projekt lejon vetëm votëbesim konstruktiv, kryeministri nuk mund ta kërkojë votëbesimin me shpresë se do të çojë në zgjedhje të reja.

64 Deputetët nuk mund ta keqpërdorin këtë tagër duke e detyru Kuvendit të votojë në pafundësi për kandidatë që nuk gëzojnë mbështetjen e shumicës. Prandaj, i njëjti deputet mund ta kërkojë emërimin e kryeministrit vetëm një herë në muaj. Deputetët që nuk kanë nënshkru një kërkesë janë të lirë ta paraqesin kandidatin e tyre. Kësisoj, nëse kandidati i një grupi dështon, mund të votohet menjëherë kandidati i grupit tjetër. Deputetët gjithashtu do të sigurohen se kanë votat e nevojshme para se të paraqesin kandidatin e tyre.

4. **Pëlqimi.** Prijetari jep pëlqimin për emërimin e anëtarit të Qeverisë brenda 7 ditëve.
5. **Mosemërimi.** Prijetari mund ta shpërndajë Kuvendin nëse Kuvendi nuk emëron Kryeministrin brenda tre muajve pas zgjedhjeve ose pasi zyra e Kryeministrit mbetet e lirë.

Neni 40. Mandati

1. Kohëzgjatja. Anëtari i Qeverisë nis mandatin pasi betohet. Qëndron në detyrë deri kur të betohet pasuesi, përveç nëse dorëhiqet, shkarkohet, ose vdes.
2. **Llogaridhënia.** Qeveria i përgjigjet për punën e vet Kuvendit.
3. Përgjegjësia. Anëtarët mbajnë bashkëpërgjegjësi për vendimet e Qeverisë, përveç nëse kundërshtojnë vendimin kur merret dhe e dëshmojnë kundërshtimin. Secili mban përgjegjësi të veçantë për vendimet brenda fushëveprimit të vet.
4. **Mungesa.** Në mungesë të Kryeministrit, detyrën e tij e ushtron zëvendësi. Zëvendësin e emëron nga radhët e ministrave Kryeministri, Qeveria, ose Prijetari.⁶⁵
5. **Puna.** Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri përcaktohen me ligj dhe rregullore.

65 Në rastin më të mirë, vetë kryeministri do ta emëronte zëvendësin e vet. Nëse kryeministri nuk mund ta bëjë këtë, atëherë e bën Qeveria. Nëse as Qeveria s'është në gjendje të veprojë, zëvendëskryeministrin e cakton Prijetari.

Kreu VI

Gjyqësia

Neni 41. Përcaktimi

1. **Në përgjithësi.** Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e pavarura dhe të paanshme. Ato ndajnë drejtësinë sipas Kushtetutës, ligjeve të tjera, dhe vendimeve paraprijëse.
2. **Vendimet.** Vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore.
3. **Lëndët.** Gjykatat shqyrtojnë vetëm lëndë ose mosmarrëveshje të mirëfilltë mes palëve kundërshtare që paraqiten para gjykatës.⁶⁶
4. **Ankesa.** Ligji përcakton të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit gjyqësor në gjykatë më të lartë.

Neni 42. Gjykata e Naltë

1. **Në përgjithësi.** Gjykata e Naltë është gjykata më e lartë e Besëlidhjes.
2. **Tagri.** Gjykata e Naltë ka tagër:
 - (1) të caktojë sipas ligjit rregulla të procedurës dhe praktikës gjyqësore; dhe
 - (2) të bartë përgjegjësi të tjera të parapara me Kushtetutë e ligj.
3. **Gjykatat e tjera.** Gjykatat më të ulëta themelohen me ligj.
4. **Vendimet.** Vendimi i Gjykatës së Naltë botohet. Hyn në fuqi ditën që botohet, përveç kur Gjykata zgjedh datë më të vonshme. Mendimi mospajtures i gjyqtarëve botohet bashkë me vendimin.

⁶⁶ Kusht. ShBA (1789/1992), neni III.2.1 (*case or controversy*); p.sh., rasti *Lujan v. Defenders of Wildlife*, 504 U.S. 555, GJS ShBA (1992).

Neni 43. Dhoma Kushtetutore

1. **Në përgjithësi.** Dhoma Kushtetutore e Gjykatës së Naltë⁶⁷ vendos çështjet që kanë të bëjnë me Kushtetutën.
2. **Përbërja.** Dhoma Kushtetutore ka 9 gjyqtarë kushtetutorë.
3. **Tagri.** Dhoma Kushtetutore ka tagër:
 - (1) të shpallë të pavlefshme ligjet dhe aktet që janë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe
 - (2) të bartë përgjegjësi të tjera të parapara me Kushtetutë e ligj.
4. **Pavarësia.** Dhoma Kushtetutore është e pavarur dhe përcakton mëvetësisht buxhetin dhe rregullimin e brendshëm sipas ligjit.
5. **Palët dhe rastet.** Përveç rasteve të tjera të parapara me Kushtetutë, mund t'i drejtohen Dhomës Kushtetutore:
 - (1) cilado dhomë e Kuvendit, Prijetari, Qeveria, dhe Mbrojtësi i Popullit për shqyrtimin e një ligji ose një akti të një organi shtetëror;
 - (2) 10 anëtarë të Kuvendit për shqyrtimin e një ligji të miratuar para se të hyjë në fuqi;
 - (3) një legjislaturë e një shteti, kreu i një shteti, ose kreu i qeverisë së një shteti për shqyrtimin e një ligji ose një akti të Besëlidhjes që cenon tagrin e shteteve;
 - (4) gjykata për shqyrtimin e një akti të kontestuar në procedurë gjyqësore;⁶⁸
 - (5) cilido anëtar i Kuvendit për shqyrtimin e një akti që cenon të drejtat e komuniteteve;
 - (6) pala që i janë shkelë të drejtat, por pasi të ketë shterë mjetet juridike; dhe
 - (7) palët e tjera të autorizuara me ligj.

67 Alternativë: *Gjykata Kushtetutore*. Ndonëse parashihet si pjesë e Gjykatës së Naltë, Dhoma Kushtetutore është plotësisht e pavarur. Ajo është përfshi këtu për thjeshtësi.

68 Shih vendimin 52/2012, GjKSh (për referimet kushtetuese nga gjykatat).

Neni 44. Këshilli Gjyqësor

1. **Në përgjithësi.** Këshilli Gjyqësor është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili siguron pavarësinë, paanësinë, dhe profesionizmin e gjykatave dhe gjyqtarëve të Besëlidhjes.
2. **Përbërja.** Këshilli Gjyqësor ka 13 anëtarë.
3. **Tagri.** Këshilli Gjyqësor ka tagër:
 - (1) të përpilojë rregulla sipas ligjit për punën e gjykatave;
 - (2) të mbikëqyrë dhe mbarështojë gjykatat;
 - (3) të hartojë dhe mbikëqyrë buxhetin e gjykatave;
 - (4) të disiplinojë gjyqtarët;⁶⁹
 - (5) të përcaktojë numrin e gjyqtarëve të nevojshëm;
 - (6) të rekomandojë themelimin e gjykatave të reja;
 - (7) të njoftojë Kuvendin e Madh për gjendjen e gjyqësisë të paktën një herë në vit; dhe
 - (8) të bartë përgjegjësi të tjera të parapara me Kushtetutë.
4. **Përbashmë.** Këshilli Gjyqësor nuk ka tagër mbi Dhomën Kushtetutore.

Neni 45. Emërimi

1. **Kushtet.** Gjyqtarët dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor emërohen përmes një ecurie të hapur, dhe kriterëve të përcaktuara me ligj. Ata duhet të jenë qytetarë me karakter të lartë moral dhe juristë me përvojë.
2. **Gjyqtarët.** Gjyqtarët i emëron Këshilli Gjyqësor me pëlqimin e Prijetarit. Gjyqtarët kushtetutorë i emëron Kuvendi i Madh me tri të pestat e anëtarëve dhe me pëlqimin e Prijetarit.
3. **Këshilli Gjyqësor.** Gjyqtarët emërojnë 7 dhe Kuvendi i Madh me shumicën e anëtarëve dhe me pëlqimin e Prijetarit 6 anëtarë të Këshillit Gjyqësor.

69 Në këtë paragraf mund të shtohen punonjësit e tjerë të drejtësisë.

Neni 46. Mandati

1. **Kohëzgjata.** Gjyqtari shërben deri në moshën ligjore të pensionimit. Gjyqtari kushtetutor shërben 9 vjet dhe anëtari i Këshillit Gjyqësor 5. Secili qëndron në detyrë deri kur të betohet pasuesi, përveç nëse shkarkohet ose vdes. Gjyqtari kushtetutor ose anëtari i Këshillit Gjyqësor nuk mund të riemërohet.
2. **Papajtueshmëria.** Gjyqtari ose anëtari i Këshillit Gjyqësor nuk mund:
 - (1) të ushtrojë detyrë në organe shtetërore jashtë gjyqësisë;
 - (2) të përfshihet në veprimtari politike; ose
 - (3) të përfshihet në veprime a sjellje që bien ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e gjyqtarit ose anëtarit të Këshillit Gjyqësor.
3. **Mbrojtja.** Gjyqtari nuk mund të bartet kundër vullnetit të vet, përveçse:
 - (1) për mbarëvajtjen e gjyqësisë;
 - (2) për zbatimin e masave disiplinore; ose
 - (3) kur me ligj parashihet ndryshe.

Neni 47. Shkarkimi

1. **Rastet.** Një gjyqtar ose anëtar i Këshillit Gjyqësor mund të shkarkohet nëse:
 - (1) dënohet për krim të rëndë;
 - (2) shpallet i paaftë mendërisht ose trupërisht; ose
 - (3) shpërfill rëndë detyrat e gjyqtarit ose anëtarit të Këshillit Gjyqësor.
2. **Ecuria.** Gjyqtarin e shkarkon Këshilli Gjyqësor me pëlqimin e Prijetarit. Gjyqtarin kushtetutor dhe anëtarin e Këshillit Gjyqësor e shkarkon Kuvendi i Madh me dy të tretat e anëtarëve dhe pëlqimin e Prijetarit.
3. **Ankimi.** Gjyqtari i shkarkuar ka të drejtë t'i ankohet Gjykatës së Naltë.

Kreu VII

Organet e posaçme

Neni 48. Në përgjithësi

1. **Përcaktimi.** Organet e posaçme janë trupa të pavarur dhe të paanshëm që caktohen me ligj për të bartë përgjegjësi të posaçme. Kanë staf meritor profesionist.
2. **Lista.** Janë organe të posaçme:
 - (1) përndjekësit botorë,⁷⁰ që ndjekin të dyshuarit për shkelje të ndëshkueshme ose shkelje të tjera sipas ligjit;
 - (2) Mbrojtësi i Popullit, që mbron të drejtat themelore nga autoritetet botore;
 - (3) Rishikuesi i Përgjithshëm, që vëzhgon përdorimin e pares botore dhe veprimtarinë ekonomike të Besëlidhjes;
 - (4) Komisioni Kombëtar i Zgjedhjeve, që organizon zgjedhjet dhe shpall rezultatet e tyre;
 - (5) Banka e Shqipërisë, që pret monedhën shqiptare, zbaton mëvetësisht politikën monedhëre, dhe mban e mbarështon kursimet valutore të Besëlidhjes;
 - (6) Komisioni i Medieve, që rregullon valët e transmetimeve;
 - (7) Këshilli i Shërbimit Qytetnor, që mbron parimet e stafit meritor;⁷¹ dhe
 - (8) agjencitë e pavarura të themeluara për të bartë përgjegjësi mbarështuese sipas një udhëzimi të qartë.
3. **Pavarësia.** Ligji që rregullon një organ të posaçëm ia siguron pavarësinë dhe mjetet e nevojshme për punë. Organi i posaçëm e mbarështon mëvetësisht buxhetin.

⁷⁰ Alternativë: *prokuroria e Besëlidhjes*.

⁷¹ Shih rastin KO 171/18, GjKK, Aktgjyk. 25.4.2019 (rreth autoritetit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil).

4. **Papajtueshmëria.** Drejtuesi ose zyrtari i lartë i një organi të posaçëm nuk mund të përfshihet në veprimtari politike.
5. **Autoriteti.** Çdo zyrtar, organ shtetëror, dhe autoritet tjetër ka detyrë të bashkëpunojë me organet e posaçme dhe t'u përgjigjet kërkesave që bëjnë brenda fushëveprimeve të tyre.

Kreu VIII

Mbrojtja dhe rendi

Neni 49. Organet

1. **Në përgjithësi.** Organet e mbrojtjes dhe rendit varen nga organet e zgjedhura. Kuvendi ua mbikëqyr buxhetin dhe politikat sipas ligjit.
2. **Ushtria.** Ushtria është forcë përgjegjëse me mbrojtje vendin. Përbëhet nga forcat tokësore, ujore, dhe ajrore. Prijetari është kryekomandant i Ushtrisë. Ai emëron dhe shkarkon Kreun e Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantët e forcave tokësore, ujore, dhe ajrore.
3. **Këshilli i Sigurisë.** Këshilli i Sigurisë është organ këshillues i Prijetarit. Përgatit strategjinë e mbrojtjes kombëtare dhe bart përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj. Këshillin e përbëjnë Kryeministri, ministri i mbrojtjes, ministri i brendshëm, dhe anëtarët e tjerë sipas ligjit.
4. **Policia.** Policia e Besëlidhjes është organ profesionist përgjegjës me ruajtje rendin e sigurinë botore bashkë me policitë e shteteve dhe me kontrollu bashkë me Ushtrinë kufirin e Besëlidhjes. Drejtorin e përgjithshëm të Policisë e emëron Kryeministri me pëlqimin e Prijetarit.
5. **Zbulimi.** Agjencia e Zbulimit është organ profesionist që heton kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare. Drejtorin, zëvendës drejtorin,

dhe rishikuesin e Agjencisë i emëron Kryeministri me pëlqimin e Prijetarit. Agjencia u jep të njëjtat njoftime Prijetarit dhe Kryeministrit.

6. **Papajtueshmëria.** Nuk mund të ushtrojnë detyra të tjera botore ose të marrin pjesë në veprimtari politike:
 - (1) ushtarakët e shërbimit vepror;
 - (2) pjesëtarët e Policisë; dhe
 - (3) pjesëtarët e Agjencisë së Zbulimit.

Neni 50. Masat e jashtëzakonshme

1. **Në përgjithësi.** Masat e jashtëzakonshme mund të ndërmerren sa janë të domosdoshme shkaku i gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme. Masat duhet të jenë në përpjesëtim me rrezikun dhe të synojnë me rikthym sa më shpejt gjendjen e rregullt.⁷²
2. **Ligji.** Rregullohen me ligj puna e autoriteteve botore, kufizimi i të drejtave themelore, dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara gjatë masave të jashtëzakonshme.
3. **Lufta.** Në rast agresioni të armatosur ndaj vendit, Prijetari shpall me dekret gjendjen e luftës. Në rast kërcënimesh të jashtme, Prijetari shpall gjendjen e luftës dhe mobilizimin në këshillim me Këshillin e Sigurisë dhe me pëlqimin e Kuvendit të Madh. Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet gjatë gjendjes së luftës, Prijetari nxjerr dekrete me fuqinë e ligjit.
4. **Gjendja e jashtëzakonshme.** Në rast rreziku për rendin kushtetutor ose për të parandaluar a mënjanuar pasojat e një fatkeqësie natyrore a teknologjike, mund të shpallet gjendje e jashtëzakonshme në pjesën e prekur të vendit. Gjendjen e jashtëzakonshme e shpall Qeveria me pëlqimin e Prijetarit për deri në 60 ditë. Kuvendi i Madh mund ta zgjasë për 30 ditë të tjera me dy të tretat e anëtarë-

⁷² Ky nen mbështetet në radhë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (1998/2016), pjesa 16, nenet 170–76, dhe pjesërisht në Kushtetutën e Kosovës (2008/2016). Pas trazirave të 97-s, Shqipëria e ka kufizu maksimalisht mundësinë e keqpërdorimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

ve, por jo më shumë se tri herë. Nëse Policia nuk është në gjendje të rivendosë rendin, Kuvendi i Madh i jep leje Ushtrisë me ndërhy.

5. **Kufizimi i të drejtave.** Akti që ndërmerr masa të jashtëzakonshme cilëson të drejtat që kufizohen.
6. **Të ndaluara.** Gjatë masave të jashtëzakonshme, nuk mund:
 - (1) të ndryshohen Kushtetuta, ligjet për zgjedhjet, ose ligjet për masat e jashtëzakonshme;
 - (2) të mbahen zgjedhje; ose
 - (3) të kufizohen të drejtat e parapara nga nenet 8, 9, 12, 13, dhe 15.
7. **Shqyrtimi në Kuvend.** Kuvendi i Madh shqyrton aktet e masave të jashtëzakonshme në mbledhjen më të parë. Nëse nuk i miraton, aktet humbin fuqinë.

Kreu IX Të ndryshme

Neni 51. Zgjedhjet

1. **Shpallja.** Zgjedhjet i shpall Prijetari, duke ua caktuar ditën.
2. **Dita.** Zgjedhjet mbahen të dielën e dytë të marsit, majit, shtatorit, ose nëntorit.
3. **Shkurtimi i mandatit.** Zyrtarëve që zgjedhen mund t'u shkurtohet mandati ashtu që zgjedhjet e parapara për një vit të mbahen të njëjtën ditë.⁷³

⁷³ Alternativë: «Zgjedhjet e parapara për një vit mbahen të njëjtën ditë, për sa është e mundshme. Për këtë qëllim, Prijetari mund t'ua shkurtojë deri në një vit mandatin zyrtarëve që zgjedhen».

4. **Vota për kandidatin.** Vota e qytetarit mund t'i njuhet vetëm kandidatit që zgjedh qytetari. Vota nuk mund t'i njuhet grupit ose partisë politike në të cilën bën pjesë kandidati.

Neni 52. Betimi

1. Prijetari, Kuvendi, Qeveria. Prijetari, anëtarët e Kuvendit, dhe anëtarët e Qeverisë bëjnë këtë betim: «Betohej se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të tjera të vendit, do të respektoj të drejtat themelore të secilit, do të mbroj pavarësinë e Shqipërisë, dhe do t'i shërbej të mirës së përgjithshme dhe përparimit të popullit tonë».
2. **Gjyqtarët.** Gjyqtarët dhe zyrtarët e tjerë betohen sipas formulës së përcaktuar me ligj se do t'i binden Kushtetutës dhe ligjeve të tjera të vendit dhe do ta kryejnë me besnikëri detyrën që pranojnë.

Neni 53. Shlirimet

1. Në përgjithësi. Lirohen nga ndjekja ndëshkimore, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet e vendimet brenda fushëveprimit të tyre Prijetari, anëtarët e Kuvendit, anëtarët e Qeverisë, gjyqtarët, anëtarët e Këshillit Gjyqësor, përndjekësit, dhe zyrtarët e lartë të një organi të posaçëm. Nuk gëzojnë shirim nëse shkelin ligjin qëllimisht.⁷⁴
2. **Ndalimi.** Nuk mund të ndalohet ose burgohet pa pëlqimin e organit ku shërben anëtari i Kuvendit, gjyqtari, ose përndjekësi, përdërisa është duke i kryer detyrat e veta.
3. **Gjyqtarët.** Gjyqtari mund të ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme vetëm me pëlqimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prijetarit. Gjyqtari kushtetutor ose anëtari i Këshillit Gjyqësor mund të ngarkohet

⁷⁴ Zyrtarët e lartë të shtetit rëndom gëzojnë imunitet funksional, që domethënë se lirohen nga përndjekja për veprimet brenda kompetencave të tyre. Në vend se me përsëritë këtu rregull sa herë që diskutohet një zyrtar ose organ i shtetit, i kam përfshi të gjithë në një vend. Shih rastin KO 98/11, GjKK, Aktgjyk. 20. 9.2011.

me shkelje të ndëshkueshme, të kontrollohet, ose t'i hiqet liria vetëm me pëlqimin e Dhomës Kushtetutore.

4. **Rrogat.** Nuk mund t'i ulet rroga gjatë kohës sa shërben Prijetarit, gjyqtarit, anëtarit të Këshillit Gjyqësor, ose zyrtarit të lartë të një organi të posaçëm. Rrogat e tyre rriten çdo vit në përputhje me shtrenjtimin e përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve.⁷⁵

Neni 54. Ndryshimi i Kushtetutës

1. **Nisma.** Mund të parashtrijë ndryshimin e Kushtetutës kushdo që ka të drejtë t'i parashtrijë Kuvendit projektligj.
2. **Miratimi.** Ndryshimi miratohet kur:
 - (1) dy të tretat e anëtarëve të secilës dhomë të Kuvendit votojnë për; dhe
 - (2) dy të tretat e anëtarëve të secilës dhomë të legjislativave të shteteve japin pëlqimin brenda 5 vjetëve pasi votohet ndryshimi në Kuvend.
3. **Shqyrtimi gjyqësor.** Pasi ta miratojë ndryshimin, Kuvendi ia paraqet atë Gjykatës së Naltë. Brenda 30 ditëve, Gjykata vlerëson nëse ndryshimi pakëson të drejtat themelore ose sovranitetin e popullit. Nëse vlerëson se po, e kthen ndryshimin për rishqyrtim në Kuvend dhe cek arsyet pse po e kthen; nëse vlerëson se jo, ia paraqet Prijetarit për ta shpallë.

Neni 55. Kalimtare

1. **Ligjet e mëparshme.** Ligjet e miratuara më parë mbeten në fuqi sa janë në pajtim me këtë Kushtetutë dhe nuk janë ndryshuar ose shfuqizuar.

⁷⁵ Mbështetë në kushtetutën e ShBA-së (1789/1992), neni III.1.1.. Çështja e rrogave mund të rregullohet në një nen i veçantë që përfshin dhe këtë dispozitë: «Caktohen me ligj rrogat e Prijetarit, anëtarëve të Kuvendit, anëtarëve të Qeverisë, gjyqtarëve, anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përndjekësve, dhe zyrtarëve të lartë të një organi të posaçëm».

Parimisht, kjo mund të nënkuptohet, por në Kosovë tashmë kemi një vendim të Gjykatës që ka leju rritjen e rrogave me vendim të ekzekutivit. Rasti KO 12/18, GjKK, Aktgjyk. 11.6.2018.

2. **Ligji kalimtar.** Çështjet kalimtare rregullohen me ligj të veçantë për zbatimin e Kushtetutës. Ai ligj miratohet në të njëjtën mënyrë si Kushtetuta, dhe nuk i nënshtrohet rishikimit gjyqësor.
3. **Në fuqi.** Kjo Kushtetutë hyn në fuqi ditën që e shpall Prijetari.